



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:269554
Datë: 23.01.2020
Numri i dokumentit: 00780360

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për çështje administrative, Divizioni Fiskal, me gjyqtarin Krenar Berisha, dhe me sekretaren juridike Nazife Sheholli, në konfliktin administrativ, të paditësit A. Shpk me seli në Prishtinë kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike: vlerësim i mallit, duke vepruar sipas aktgjykimit AA.nr.97/2014 i datës 12.04.2018 i Gjykatës së Apelit të Kosovës, në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 15.01.2020, në mungesë të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse, e në prani të përfaqësueses së autorizuar të palës së paditur, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET Kërkesëpadia e paditësit A. Shpk me seli në Prishtinë

ANULOHET Aktvendimi nr.06.1.4/759, 763 të datës 16.07.2009 i Doganës së Kosovës dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës AA.nr.97/2014 i datës 12.04.2018 është aprovuar ankesa e ankuesit Dogana e Kosovës në Prishtinë, duke anuluar aktvendimin A.nr.283/2009-DK të datës 04.01.2013 të Bordit të Pavarur për Rishqyrtime në Prishtinë, dhe lënda është kthyer në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje administrative-Divizionit Fiskal, në rigjykim dhe rivendosje.

Paditësi A. Shpk me seli në Prishtinë me ankesën e datës 25.08.2009 drejtuar BPR-së, e kundërshton vendimin nr.06.1.4/759, 763 të datës 16.07.2009 i Doganës së Kosovës me arsyetimin se: me rastin e paraqitjes së mallit doganor Deklaratës doganore i janë bashkangjitur të gjitha dokumentet përcjellëse të mallit të cilat kërkohen si dokumente që duhen ti bashkangjiten deklaratës doganore për vendosje të mallit në qarkullim të lirë në përputhje me nenin 4 të Udhëzimit Administrativ 2004/03. Të gjitha dokumentet janë të harmonizuara në kuptimin e vlerës së transaksionit të kryer për mallin e blerë. Dega doganore fare nuk i ka analizuar dokumentet e bashkangjitura deklaratës doganore, sepse nga këto dokumente mund të konstatohet se malli doganor është blerë sipas vlerës së faturës, të cilën rrethanë e vërtetojnë urdhërpagesa ndërkombëtare mbi transaksionin bankar të kryer sipas numrit të pro-faturës më parë se arritja e mallit, listës paketuese, kontratës së shitblerjes së mallit, etj. Në bazë të konstatimit të gabuar dega doganore i ka aplikuar gabimisht dispozitat materiale dhe e ka detyruar ankuesin të paguaj taksat importuese më të larta nga taksat reale që ishte dashur të paguaj. Dogana ka shkelur dispozitat procedurale, sepse nuk mund ti kontestohet çmimi i mallit pa u dëshmuar jovaliditeti i dokumenteve të mallit. Dogana, për ta ngritur çmimin është dashur të bëjë dhe akoma ka mundësi të bëjë verifikimin e dokumenteve, përkatësisht të bëjë verifikimin e çmimit, me të cilin ai mall është importuar, duke u bazuar në komunikimin direkt me eksportuesin e këtij malli, nëpërmjet adresave të eksportuesit të shënuara në dokumentet përcjellëse të mallit.

Përfaqësuesja e autorizuar e të paditurës në seancën e shqyrtimit kryesor deklaron: e kundërshtoi në tërësi padinë e paditësit si të pa bazuar, dhe i propozoj gjykatës që të njejtën ta refuzoj si të pa bazuar, dhe të lë në fuqi aktvendimin Doganës së Kosovës, për arsye se aktvendimi është i bazuar në ligj, dhe konsiderohet si vendim i drejtë, për arsye

se subjekti në rastin e deklarimit të mallit nuk e ka deklaruar saktë vlerën e mallit, është deklaruar vlerë më e ulët sesa vlera reale e paguar apo që ka për tu paguar për mallin e shitur për eksport përkatësisht import në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave. Po ashtu Dogana e Kosovës ka vepruar drejtë dhe është bazuar në metodën e gjashtë të vlerësimit, neni 35 i Kodit Doganor dhe të Akcizave, respektivisht në bazë të të dhënave të disponueshme. Vlen të theksohet se sipas vendimit përfundimtar BPR-së, 283/2009- DK i datës 04.01.2014, Dogana e Kosovës i ka kthyer mjetet në bazë të vendimit nr.07.4/759 dhe 763 të datës 26.03.2014, andaj i propozoj gjykatës që të obligoj paditësin për kthimin e shumës së cekur më lartë. Mbesim prapa vendimit kontestues me nr. 06.1.4/759 dhe 763 të datës 16.07.2009, i cili vendim konsiderohet i drejtë dhe i ligjshëm në të cilin është dhënë arsyetimi i duhur.

Gjykata ka shqyrtuar këtë konflikt administrativ gjyqësor në pajtim me dispozitat e nenit 41 të LKA-së, për arsye se përfaqësuesi i autorizuar i paditësit edhe pse është ftuar në mënyrë të rregullt nga gjykata, nuk ishte prezent dhe nuk e ka arsyetuar mos ardhjen në seancë gjyqësore.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 15.01.2020, ka administruar provat relevante dhe atë: përgjigja në padi e datës 15.05.2014, aktvendimi nr. 06.1.4/759 dhe 763 i datës 16.07.2009 i Doganës së Kosovës, aktvendimi nr. prot. 217/30.01.2014 i BPR-së, aktvendimi A.nr. 283-DK/2009 i datës 04.01.2013 i BPR-së, ankesa e paditësit me nr. prot. 283 datë 25.08.2009, urdhërpagesa e datës 12.01.2009, deklaratat doganore, Dokumenti Unik Doganor, deklarata e të dhënave në lidhje me vlerën doganore DV1 datë 17.04.2009, autorizimi për import i datës 15.05.2009, dosja e të dhënave të disponueshme datë 17.07.2009, aktgjykimi AA.NR. 97/2014 i datës 12.04.2018 i Gjykatës së Apelit të Kosovës, faturat e mallit, kontrata e shitjes, dosja e vlerës.

Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 81G të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, në seancën e mbajtur me datë 15.01.2020 vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, dhe konstatoi se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, andaj vendosi që të aprovohet padia e paditësit si e bazuar.

Në këtë procedurë të konfliktit administrativ gjyqësor gjykata ka vepruar sipas vërejtjeve të dhëna në arsyetimin e Aktgjykimit AA.97/2014 dt.12.04.2018 të Gjykatës së Apelit të Kosovës, me të cilin është kërkuar të shqyrtohet ligjshmëria e vendimit nr.06.1.4/759, 763 të datës 16.07.2009 i Doganës së Kosovës.

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, gjykata ka nxjerr konstatimin se paditësi ka deklaruar mallin për zhdoganim në Zyrën Doganore Pejë, me ç'rast pas pranimit dhe vlerësimit të DUD-ave kontestues, Dogana e Kosovës ka aplikuar metodën e katërt dhe gjashtë të vlerësimit respektivisht sipas çmimit të tregut tonë si dhe në bazë të të dhënave të Doganës së Kosovës, pasi që paditësi ka deklaruar vlerë më e vogël se sa vlera reale e paguar apo që ka për tu paguar për mallin e shitur për eksport përkatësisht për import në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës nr. 03/L-109. Dogana e Kosovës ka theksuar se është bazuar në metodën e gjashtë të vlerësimit neni 35 të Kodit Doganor dhe Akcizave të Kosovës, respektivisht në bazë të të dhënave të disponueshme, dhe për emërtimet 5,12,15 të DUD-it 7407/17.05.2009 dhe emërtimet 4,11 të DUD-it 7665/20.05.2009 ka vlerësuar në bazë të metodës së katërt të vlerësimit neni 34 par.2 pika (c) të Kodit Doganor dhe të Akcizave. Dokumentacioni përcjellës i mallit nuk është pranuar me arsyetimin se mungon deklarata eksportuese si dhe fatura nuk është e vulosur nga autoritetet doganore. E paditura ka Hudhur poshtë kërkesën e paditësit për rishqyrtimin e vendimit nr.5201/14.04.2009 të ZD Pejë

Gjykata vlerëson se arsyetimi i vendimit kontestues është i mangët dhe nuk i ka elaboruar të gjitha çështjet dhe faktet vendimtare që kanë të bëjnë me pretendimet ankimore të paditësit lidhur me dokumentacionin përcjellës të mallit doganor të deklaruar me DUD-at 7407/17.05.2009, 7460/18.05.2009, 7665/20.05.2009 në ZD Pejë. Gjykata konstaton se aplikimi i metodës së 4 dhe 6 të vlerësimit në vështrim të nenit 34 par.2 pika (c) dhe neni 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave, është veprim i cili bie ndesh me dispozitat e nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave nr.03/L-109, për arsye, se para se të aplikohen metodat e fundit e vlerësimit, duhet të jepen arsye dhe provat për ta kontestuar vlerën e mallit lëndor dhe dokumentacionin e dorëzuar me kërkesë nga paditësi si faturat e mallit, kontrata e shitjes dhe urdhërpagesat bankare, të cilat dokumente nuk janë shqyrtuar dhe as kontestuar nga e paditura në kuptim të harmonizimit të vlerës së mallit, në përputhje me dispozitat e nenit 123 të Udhëzimit Administrativ 11/2009 për implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave.

Në arsyetimin kontestues nuk është dhënë arsyetim i bazuar, përse vlerësimi nuk mund të bëhet me metodën e parë të vlerësimit në vështrim të nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës nr.03/L-109, kur paditësi ka prezantuar dokumentacionin valid që dëshmon për çmimin e paguar, e paditura nuk e ka mbështetur konstatimin e vet në asnjë dispozitë ligjore që do të përcaktonte se deklarata eksportuese duhet bashkangjitur faturës së mallit doganor, për tu aplikuar vlera e transaksionit të mallit konform nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave, por duke i anashkaluar dëshmit mbi pagesën e vlerës së mallit përmes transferit bankar, faturës së mallit, e paditura vlerëson mallin me metodat tjera të vlerësimit.

Gjykata kërkon nga e paditura Dogana e Kosovës që në ri procedurë para se të aplikoj çmimet e tregut dhe të dhënat e disponueshme që disponon për mallin lëndor, të vlerësoj metodat paraprake të vlerësimit, të verifikoj vërtetësinë e dokumentacionit përcjellës të mallit në aspektin e harmonizimit të vlerës së mallit të deklaruar, ashtu që të shqyrtoj pretendimet e paditësit se ka prezantuar dokumentet e nevojshme që kërkohen me dispozitat e nenit 123 të Udhëzimit Administrativ 11/2009 mbi implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109, të verifikohet vlera e paguar sipas transferit bankar dhe se ajo harmonizohet me vlerën e deklaruar sipas faturës përcjellëse të mallit kontestues dhe dokumentacionet tjera përcjellëse. Në ri procedurë e paditura të sqaroj se cila bazë ligjore kërkon që deklarata eksportuese paraqet dokument vendimtar në vlerësimin e mallit doganor, edhe pse në këtë rast paditësi ka paraqit dokumentacion që dëshmon vlerën e mallit kontestues si: kontrata e shitblerjes, transferet bankare, faturat e mallit. Lidhur me vendimin mbi Hudhjen poshtë të kërkesës së paditësit për rishqyrtimin e vendimit 5201/14.04.2009 në Z.D. Pejë, si e ushtruar jashtë afatit ligjor, gjykata e udhëzon të paditurën që në rast se paditësi nuk paraqet ndonjë fakt tjetër relevant lidhur me afatshmërin e ankesës, e paditura të konfirmoj ankesën si të paraqitur jashtë afatit ligjor. Me rastin e nxjerrjes së vendimit të ri e paditura të vlerësoj drejt gjendjen faktike që rezulton nga dokumentacioni i mallit dhe të aplikoj drejt dispozitën ligjore me të cilën përcaktohet vlerësimi i mallit.

Duke pasur parasysh konstatimet e sipërcekura, gjykata konkludon se në këtë konflikt administrativ ekzistojnë të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, ku ka rezultuar të mos dihen arsyet e mos kontestimit të vërtetësisë së dokumentacionit të mallit të prezantuar në procedurën administrative të ankesave. Andaj në këtë drejtim gjykata bazuar në autorizimet nga nenit 81.I par.2 pika 2.2 të Ligjit nr.04/L-102, neni 43 par.2 të LKA-së e detyron organin e paditur Dogana e Kosovës në Prishtinë, që në ri procedurë të veprojnë sipas vërejtjeve të dhëna në arsyetim të këtij aktgjykimi, duke pasur parasysh se nuk janë vlerësuar në mënyrë të drejtë të gjitha faktet që kishin me ndikuar në vendosjen e drejtë të çështjes.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal
A.nr.1007/18, datë 15.01.2020

Gj y q t a r i
Krenar Berisha

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 60 ditësh nga marrja e të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2019:269554
Datë: 23.01.2020
Numri i dokumentit: 00780360